



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 25.3.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq, Shaip Muja.

Munguan : Haxhi Shala, Salih Salihu, Emilija Redzepi.

Të ftuar dhe pjesmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Duda Balje**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 14.3.2016,
3. Shqyrtimi i rekomandimit për mbledhjen plenare për kandidatët e intervistuar,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesja **Duda Balje** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 14.3.2016

Procesverbali nga data 14.3.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i rekomandimit për mbledhjen plenare për kandidatët e intervistuar

Kryesuesja hapi diskutimin rreth kësaj pike ngase në ndërkohë janë konstatuar disa paqartësi rreth kushteve të kandidatëve të cilat mirë do të ishte të saktësohen sipas sajë. Ajo hapi diskutimin rreth pozitës së Drejtorit nëse ka dikush vërejtje. **Shaip Muja** kishte vërejtje rreth kandidatit për drejtor Nazmi Jashari i cili është këshilltar politik i Ministrit përkatës dhe se në këtë mënyrë po shkohet nga ajo që partitë po i rrahatojnë njerëzit e vetë nëpër vende publike, ndërsa **Adem Salihaj** konstatoi se nuk ka pengesa ligjore në këtë rast ngase çdo kush ka drejt të konkurroi, vetëm nëse zgjedhet në atë pozitë do ti ndalohen orientimet politike. Ai konstatoi se komisioni është në kuadër të ligjit. **Murat Hoxha** gjithashtu konstatoi bazueshmërinë në ligj punës së komisionit ngase kandidati duhet ti plotësoi kushtet obligative, kurse për zvendës drejtor gjithashtu duhet të vlej parimi i plotësimeve strikt të kushteve të parapara. **Shaip Muja** potencoi faktin se njëri kandidat 63 vj. a duhet me pas drejt të kandidoi. Edhe pse Komisioni votoi 4 për me 1 kundër për dy kandidat për drejtor, **Srdjan Popoviq** tha se kemi vepruar si komision ne bazë të Ligjit dhe kemi përzgjedhë kandidatët por tani duhet të veprojmë edhe me konsensus nëse ka nevojë dhe të dërgojmë mbledhjes plenare. **Kryesuesja** ndërpreu mbledhjen e sotme për të vazhduar të martën me pyetjet që duhet të sqarohen nga zyra ligjore si vijon :

- A është pengesë ligjore kandidimi i personit 63 vj.
- A është pengesë ligjore kandidimi i këshilltarit të ministrit,
- Të konstatohet ekzistimi apo jo i përvojës menaxheriale e kandidates Kimete Pavataj Salihu,
- Për Bordin e mjedisit komisioni të njoftohet me materialin deri të martën dhe të vendoset për miratim apo jo kjo listë nga Qeveria.

Mbledhja përfundoi në orën 11,40

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Duda Balje